

D.2 PËRGATITJA E RAPORTEVE

Në modulën COBISS3/ Koleksionet e bibliotekës do të përgatitni dokumentet e biznesit nga nëngrupet **B** dhe **C**.

Dokumentet e biznesit nga nëngrupi **B** i përgatitni me metodën themelore **Klasa / Dërgo**, ndërsa dokumentet e biznesit nga nëngrupi **C** me metodën e posaçme **Objekti / Printo etiketat**.

D.2.1 Dokumentet e biznesit KB-DB-B01 dhe KB-DB-B02

Raportet i përgatitni me metodën **Klasa / Dërgo** në klasën **Fusha 996/997**. Të dhënat për përgatitjen e raportit i kërkonte dhe përzgjidhni në dritaren për kërkim **Kërkimi – Fusha 996/997**. Pas përzgjedhjes së formatit përkatës të raportit në dritaren **Përzgjedhja e përcaktimit të raportit**, duhet të futni komentin, i cili printohet në titullin e dokumentit të biznesit. Me këtë do të sqaroni se çfarë lloj të materialit mund të gjeni në raport.

D.2.2 Dokumentet e biznesit KB-DB-B04, KB-DB-B05 dhe KB-DB-B06

Raportet i përgatitni me metodën **Klasa / Dërgo** në klasën **Hyrjet e reja**. Të dhënat për përgatitjen e raportit i kërkonte dhe përzgjidhni në dritaren për kërkim **Kërkimi – Hyrjet e reja**. Pas përzgjedhjes të formatit përkatës të raportit në dritaren **Përzgjedhja e përcaktimit të raportit**, mund të futni komentin, i cili printohet në titullin e dokumentit të biznesit.

D.2.3 Dokumentet e biznesit nga KB-DB-C01 deri KB-DB-C15

Për fushat 996/997 mund të printoni etiketat, ashtu që në klasën **Fusha 996/997** kërkonte fushën 996/997 dhe përzgjidhni metodën **Objekti / Printo etiketat**. Etiketën mund ta futni edhe në redaktuesin **Fusha 996/997** duke klikuar butonin **Printo etiketat** ose në dritaren **Kontrolli i ardhjes së serialeve për fushën 997**, duke klikuar butonin **Printo etiketat**.